




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr. 02/2023

Dt:08.09.2023

Bordi për Ankesa (BA), i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Granit Mavriqi anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2308/659/BA/yf të datës 15.08.2023 të parashtruesit “Klan Kosova” Sh.P.K, të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2307/590/KPM/j.m, të datës 19.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datën 08.09.2023 mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa Ref:2308/659/BA/yf të datës 15.08.2023 e “Klan Kosova” Sh.P.K, shfuqizohet Vendimi i KPM-së, Nr. Ref. 2307/590/KPM/j.m i datës 19.07.2023, **lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.**

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref: 2307/590/KPM/j.m i datës 19.07.2023, e ka refuzuar kërkesën për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së “Radio Shqip FM”, nga biznesi individual Asdren Agushi B.I me emër tregtar NP “Radio Energji” me numër unik identifikues (NUI) 810268385 me pronar Asdren Agushi tek biznesi Klan Kosova Sh.P.K, me numër unik identifikues (NUI) 810795297, me pronar person juridik KGO Media Investments SH.P.K, me numër unik identifikues (NUI), ndërsa ky biznes me pronar juridik KGO Media Investments DOOEL EMBS: 711532 (Shkup) me pronar fizik Kushtrim Gojani.

Kundër Vendimit të lartcekur në afatin e paraparë ligjor Klan Kosova SH.P.K me datën 15.08.2023 ka parashtruar Ankesë pranë Bordit për Ankesa, për shkak: të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, anulimin e vendimit me nr.2307/590/KPM/j.m, i datës 19.07.2023 dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit Ref.2307/590/KPM/j.m i datës 19.07.2023, me propozim që Bordi për Ankesa të aprovojë Ankesën e Klan Kosova SH.P.K, si të bazuar, të Anulohet Vendimi i atakuar si i pabazuar dhe të lejohet transferimi i licencës, palës ankuese.

Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 08.09.2023 ka shqyrtuar dhe analizuar Ankesën, pretendimet ankimore dhe të gjitha provat e palës ankuese “Klan Kosova” SH.P.K., duke aprovuar

ankesën e palës ankuese si të bazuar dhe ka shfuqizuar Vendimin e KPM-së, me nr. Ref.2307/590/KPM/j.m të datës 19.07.2023, lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Bordi për Ankesa ka konstatuar se pretendimet ankimore të palës ankuese kundër Vendimit Ref:2307/590/KPM/j.m të datës 19.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të bazuara, për faktin së KPM-ja, me marrjen e vendimit lidhur me kërkesën e palës ankuese, është mbështetur në Vendimin e ARBK-së me të cilin e ka pezulluar çertifikatën e biznesit të palës ankuese, e i cili vendim nuk ka qenë i ekzekutuar dhe rrjedhimisht nuk ka prodhuar efekt juridik, po ashtu KPM, në arsyetimin e vendimit të atakuar mbështetet edhe në informacionet lidhur me adresën e pronarit të palës ankuese, se janë në kundërshtim me integritetit territorial të Republikës së Kosovës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky fakt është i ndërlidhur me vendimin e ARBK-së, e i cili Vendim nuk ka qenë i ekzekutueshëm në kohën e marrjes së Vendimit nga ana e KPM-së. Për më tepër për të hequr çdo dilemë, lidhur me këtë çështje Gjykata Komeriale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin KA.nr.315/23 të datës 02.08.2023, e ka shtyrë ekzekutimin e vendimit nr.4566/01 të datës 28.07.2023 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, dhe vendimin nr. 309/11 të datës 14.06.2023 të Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së.

KPM-ja, vendimin e saj e mbështetë në Nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit të KPM-së, Bordi për Ankesa konstaton se KPM-ja nuk ka konstatuar se cila është politika e transmetimit e cila kufizon monopolizimin e transmetimit dhe promovimin e një konkurrence të drejtë për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale. Po ashtu, KPM-ja me rastin e marrjes së vendimit, nuk ka specifikuar se me cilën praktikë nuk ka lejuar që një i licencuar të këtë më shumë së dy licenca të radios.

Bordi për Ankesa, konstaton se Vendimi i atakuar i KPM-së, lidhur me refuzimin e kërkesës së palës ankuese mbështetet në Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore pa specifikuar dispozita përkatëse, e që rrjedhimisht ky konstatim është i paqartë, i pakuptueshëm dhe nuk është konkret, pra i njëjti bie ndesh me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton:

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

- 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;***
- 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;***
- 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;***
- 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;***
- 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;***
- 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.***

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Në bazë të konstatimeve si me lartë, Komisioni i Pavarur i Mediave obligohet t'i evitojë shkeljet e lartcekura me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes për rastin në fjalë.

Lidhur me kërkesën e palës ankuese për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit Ref.2307/590/KPM/j.m të datës 19.07.2023, Bordi për Ankesa me Vendimin Nr.01/2023 të datës 18.08.2023 ka vendosur lidhur me këtë çështje.

Andaj, Bordi për Ankesa bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nenin 132 paragrafi 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit në Gjykatën Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje Administrative.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.

